

Vlerësimi i riskut Zbatimi në praktikë

Qëllimi i Vlerësimit të Riskut

Qëllimi është të mundësojë punëdhënësin të marrë masat e nevojshme për mbrojtjen e punonjësve.

Masat përfshijnë:

- Parandalimi i risqeve profesionale.
- Informimi i punëmarrësve.
- Trajnimi i punëmarrësve.
- Organizimi dhe mjetet për zbatimin e masave.

Hapat e vlerësimit të riskut

- Ndërtimi i një programi të vlerësimit të riskut
- Strukturimi i vlerësimit (vendim mbi përfaqshjen: gjeografik, funksional, proces, fluks)
- Mbledhje informacioni.
- Identifikimi i rreziqeve.
- Identifikimi i atyre nën risk.
- Identifikimi i llojeve të ekspozimit në rrezik ose risk.

Procedura e vlerësimit të riskut mund të grupohet në një sërë hapash.

- Vlerësim i risqeve (probabiliteti i dëmtimit në rrethanat aktuale)
- Hetimi i opsioneve për eliminimin apo kontrollin e risqeve.
- Prioritizimi i veprimeve dhe marrje vendimesh mbi masat e kontrollit.
- Zbatimi i kontrolleve.
- Regjistrim i vlerësimit.
- Matje e efektshmërisë së veprimit.
- Rishqyrtim (nëse kryen ndryshime apo në mënyrë periodike)
- Monitorim i programit të vlerësimit të riskut

Model i thjeshtë për ndërmarje të mesme dhe të vogla

- Hapi 1. Identifikimi i rreziqeve dhe atyre nën risk
- Hapi 2. Vlerësimi dhe prioritizimi i risqeve
- Hapi 3. Marrja e vendimeve mbi veprimet parandaluese
- Hapi 4. Ndërmarrja e veprimeve
- Hapi 5. Monitorimi dhe shqyrtimi

HAPI 1: Identifikimi i rreziqeve dhe i punëmarrësve në risk

- Identifikimi rreziqeve.
- Identifikimi i personave të ekspozuar direkt ndaj rrezikut.
- Identifikimi i personave në risk për tu ekspozuar ndaj rrezikut.
- Identifikimi i grupeve të punonjësve që mund të jenë në risk të lartë për shkak të kërkesave specifike:
 - Punonjës me aftësi të kufizuara.
 - Emigrantë
 - Punonjës të rinj dhe të moshuar
 - Gra shtatzëna apo me fëmijë nën fazë qumështi
 - Personel i patrajnuar apo pa përvojë.
 - Punonjës të përkohshëm apo me kohë të pjesshme.

Hapi 1: Disa mënyra për Identifikimin e rreziqeve dhe atyre nën risk

Identifikimin e rreziqeve dhe atyre nën risk realizohet përmes:

- Kqyrjes përreth vendit të punës.
- konsultim me punonjësit dhe përfaqësuesit e tyre.
- Shqyrtim sistematik i të gjitha aspekteve të punës.
- Kërkim në regjistrat e kompanisë për aksidentet dhe sëmundjet.
- Kërkim informacioni prej burimesh të tjerë

Hapi 2: Vlerësimi dhe prioritizimi i risqeve

- Sa janë gjasat që një rrezik të shkaktojë një dëm.
- Sa serioz do të jetë dëmi
- Sa shpesh (dhe në çfarë mase) janë punëmarrësit të ekspozuar.

Hapi 3: Marrja e vendimeve mbi veprimet parandaluese

- Nëse risqet janë të shmangshëm, eliminimi i tyre.
- Nëse risqet nuk janë të shmangshëm ose të parandalueshëm, reduktimin e tyre në masën ku mos dëmtohet shëndeti dhe siguria
- Luftimi i riskut që në burim.
- Adaptimi i punës me individin.
- Përshtatja me nivelin teknik
- Zëvendësimi i të rrezikshmeve me të parrezikshmet apo më pak të rrezikshmet
- Zhvillimi i një politikë të përgjithshme koherente parandalimi.
- Dhënie prioriteti ndaj masave të mbrojtjes kolektive kundrejt atyre të mbrojtjes personale.
- Dhënia e udhëzimeve të duhura për punonjësit.

Hapi 4. Ndërmarrja e veprimeve

Zbatimi i masave parandaluese kërkon zhvillimin e një plani që specifikon:

- Masat që duhen zbatuar
- Mjetet e caktuara (koha, shpenzimet etj)
- Personat e përfshirë dhe detyrat e gjithsecilit të specifikuar.
- Kohën kur duhet të kryhen veprimet.
- Datën për shqyrtimin e masave të kontrollit.

Është e domosdoshme që në këtë proces të përfshihen punëmarrësit dhe përfaqësuesit e tyre dhe duhet që:

- Të informohen rreth masave të mara, si do të zbatohen dhe personi përgjegjës për zbatimin e tyre.
- Të trajnohen apo udhëzohen për masat ose procedurat që do të zbatohen

Hapi 5. Monitorimi dhe shqyrtimi

- Vlerësimi i riskut nuk bëhet një herë dhe mbaron, ai duhet të shqyrtohet dhe rifreskohet sipas nevojave për tu përshtatur me:
- Nivelin e ndryshimit në aktivitetin e punës.
- Ndryshimet si proceset, pajisjet apo materialet e reja, ndryshimet në organizimin e punës dhe situatat e reja të punës, ambjentet e reja të punës etj
- Vlerësimi i riskut nuk është më i aplikueshëm, kur të dhënat dhe informacioni mbi të cilin është bazuar nuk është më i vlefshëm

- Masat parandaluese dhe mbrojtëse që janë në fuqi janë të pamjaftueshme ose të paplota p.sh kur ka informacione të reja në lidhje me masa specifike kontrolli etj
- Si rezultat i konstatimit prej një aksidenti apo prej një “pothuajse” aksidenti (që është një ngjarje e paplanifikuar dhe nuk rezultoi në plagosje, sëmundje apo dëmtim – por e kishte potencialin për ta shkaktuar këtë)

Dokumentimi i vlerësimit të riskut

Ç’do subjekt duhet që të ketë “Dokumentin e vlerësimit të riskut”

Dokumenti përdoret si bazë:

- Për të kaluar informacionin tek personat e interesuar.
- Për monitorim për të vlerësuar nëse janë marrë masat e duhura për tu mbrojtur nga rreziku.
- Për përgatitjen e evidencave (fakteve) për autoritetet mbikëqyrëse.
- Për rivlerësim në rastet e ndryshimit të rrethanave si pasojë e ndryshimit të teknologjisë etj.

Çfarë përmban dokumenti i vlerësimit të riskut

Dokumenti domosdoshmerisht duhet të ketë:

- Emrin dhe funksionin e personit/(ave) që kryen vlerësimin e riskut për çdo vend pune.
- Periudha kohore (nga date...deri ne date...) e kryerjes te vleresimit te riskut.
- Rreziqet dhe risqet që u identifikuan për çdo vend pune.
- Punemarresit ose grupet e punemarresve që përballohen me rreziqe specifike.
- Masat e nevojshme qe duhen marrë për tu mbrojtur nga rreziku.
- Masat e nevojshme që duhen marrë per te reduktuar ose eliminuar risqet.
- Hollësi të monitorimit vijues dhe rregullimet e duhura për rishqyrtimin, përfshirë datat dhe individët e përfshirë.
- Hollësi të përfshirjes së punonjësve dhe përfaqësuesve të tyre në procesin e vlerësimit të riskut.
- Firma e personave qe kane kryer vleresimin e riskut.

Rolet dhe përgjegjësitë e punëdhënësit

Plan-veprimi duhet të përfshijë:

- Komisionin, organizimin dhe koordinimin e vlerësimit te riskut
- Emërimin e personave kompetentë për të bërë vlerësimet.
- Konsultimin me përfaqësues të punëmarrësve për realizimin e emërimeve të personave që do të bëjnë vlerësime.t
- Ofrimin e informacionit të nevojshëm, trajnimin, burimet dhe mbështetjen për vlerësuesit, që janë punëmarrës të vetë punëdhënësit
- Sigurimin e komunikimit të menjëhershëm mes vlerësuesve (atje ku nevojitet)
- Përfshirjen e strukturave menaxhuese dhe nxitjen e pjesmarrjes së forcës punëtore
- Përcaktimin e rregullimeve të nevojshme që duhet të bëhen për të shqyrtuar dhe ripunuar vlerësimin e riskut
- Sigurimin që masat parandaluese dhe mbrojtëse merren parasysh në rezultatet e vlerësimit
- Sigurimin e dokumentimit të vlerësimit të riskut

- Monitorimin e masave mbrojtëse dhe parandaluese për të siguruar ruajtjen e efektivitetit të tyre.
- Informimin e punonjësve dhe/ose përfaqësuesve të tyre për rezultatet e vlerësimit dhe masat e ndërmarra (bërjen të disponueshëm të regjistrimeve të mbajtura).

Rolet dhe përgjegjësitë e punëmarrësve

Punëmarrësit dhe përfaqësuesit duhet:

- Të luajnë rol konsultativ për organizimin e vlerësimit të riskut dhe për emërimin e atyre që do të kryejnë këtë detyrë.
- Të marrin pjesë në vlerësimin e riskut.
- Të njoftojnë supervisorët apo punëdhënësit e tyre në lidhje me risqet e perceptuar.
- Të raportojnë çdo ndryshim në vendin e punës.
- Të jenë të informuar për risqet ndaj sigurisë dhe shëndetit të tyre dhe për masat e nevojshme për të eliminuar apo reduktuar këto risqe.
- Të përfshihen në procesin e vendimmarrjes për masat parandaluese dhe mbrojtëse që do të merren
- T'u kërkojnë punëdhënësve të marrin masa të përshtatshme dhe të paraqesin propozime për të minimizuar rreziqet apo për të larguar rreziqet që në burim
- Të bashkëpunojnë që të ndihmojnë punëdhënësit që të sigurojnë se mjedisi i punës është i sigurt
- Të trajnohen/të marrin udhëzime për masat që do të vendosen
- Të kujdesen sa të mundën për sigurinë dhe shëndetin dhe atë të personave të tjerë të ndikuar nga veprimet e tyre në përputhje me trajnimin dhe udhëzimet e dhëna nga punëdhënësi

Këshillim për këdo që kryen vlerësimin e riskut

- Personat që kryejnë vlerësimin e riskut në punë duhet të kenë njohuri dhe/ose informacion mbi:
- rreziqet dhe risqet që njihen tashmë që ekzistojnë dhe mënyrën se si ato lindin
- materialet, pajisjet dhe teknologjia e përdorur në punë
- procedurat e punës dhe organizimi dhe ndërveprimi i punonjësve me materialet e përdorura
- llojin, gjasat, frekuencën dhe kohëzgjatjen e ekspozimit me rreziqet. Në disa raste kjo mund të nënkuptojë aplikimin e teknikave moderne dhe të vlerësuara të matjeve
- lidhja mes ekspozimit ndaj një rreziku dhe efektit të tij
- standardet ligjore dhe kërkesat e përputhshme me risqet ekzistues në vendin e punës
- Çfarë konsiderohet si praktikë e mirë në fushat ku nuk ka standarte specifike ligjore.